



FEDERATA E PINGPONGUT E KOSOVËS
KOSOVO TABLE TENNIS ASSOCIATION

Shtëpia e Sportit, rr. Agim Ramadani nr. 253, kati I, zyra nr. 7, Prishtinë
Tel: +383-44-170-586 / Email: info@fppk.com / ueb: www.fppk.com

**REGULLORE PËR REGJISTRIMIN E KLUBEVE TË PINGPONGUT DHE TË
ANËTARËVE TË TYRE**

PRISHTINË 2026

Në përputhje me nenin 7 dhe nenin 15 paragrafi 2.1 të Statutit të Federatës së Pingpongut të Kosovës, Kuvendi i Federatës së Pingpongut e Kosovës, në mbledhjen e datës: 09.03.2026 miratoi këtë:

REGULLORE PËR REGJISTRIMIN E KLUBEVE TË PINGPONGUT DHE TË ANËTARËVE TË TYRE

Neni 1 – Qëllimi

1. Mënyra dhe kushtet për regjistrimin e klubeve të pingpongut dhe anëtarëve të tyre.
2. E drejta e paraqitjes në garat e FPPK.
3. Kalimi i sportistëve nga një klub në tjetrin.
4. Shkuarja e sportistëve në klubet e huaja dhe regjistrimi i sportistëve të huaj në klubet kosovare.
5. Licencat e sportistëve.
6. Fuzionimi ose bashkimi i klubeve.
7. Fshirja nga regjistri i klubit.
8. Puna dhe kompetencat e Komisionit të Regjistrimit dhe garave.
9. Mënyra e mbajtjes së evidencës.
10. Çështje të tjera të rëndësishme për procesin e regjistrimit.

Neni 2. – E drejta për te marre pjese në Gara

1. Me aktin e regjistrimit, klubet dhe sportistët e tyre fitojnë të drejtën për t'u paraqitur në garat e pingpongut për stinorin garues për të cilin janë regjistruar.
2. Sportisti kosovarë që nuk është i regjistruar në FPPK nuk mund të marrë pjesë në asnjë garë që është në kompetencë të FPPK-së.
3. Përgjashtim bëjnë sportistët shtetas të Kosovës, të cilët janë të regjistruar në klube të huaja dhe që, sipas dispozitave të ITTF, mund të paraqiten për përzgjedhjen e Kosovës.
4. Kohëzgjatjen e stinorit garues e përcakton Bordi Ekzekutiv i FPPK-së.
5. Në turne të hapur të drejtë pjesëmarrje kanë edhe sportistët e huaj që nuk janë të regjistruar në ndonjë klub gjatë vitit përkatës, duke paguar tarifën për pjesëmarrje.
6. Çdo sportist i regjistruar fiton të drejtën që të pajiset me licencë (kartelë) nga FPPK. .

Neni 3 – Regjistrimi i klubeve dhe të anëtarëve të tyre

1. Regjistrimin e klubeve dhe të anëtarëve të tyre e bën Komisioni i Regjistrimit dhe Garave i FPPK-së.
2. Regjistrimi bëhet pas përfundimit të stinorit garues, në afatin që përcakton Bordi Ekzekutiv i FPPK-së.
3. Përgjashtimisht, gjatë tërë vitit garues mund të bëhet ripërtëritja e regjistrimit dhe regjistrimi i parë i sportistëve të lirë.
4. Sportistët e regjistruar pas afatit të rregullt mund të marrin pjesë në gara vetjake pas 3 ditësh ndërsa në garat ekipore pas 7 ditësh.

Neni 4 – Pagesa për regjistrim

1. Me rastin e paraqitjes së kërkesës për regjistrimin e klubeve dhe të anëtarëve të tyre, si dhe për vazhdimin e regjistrimit, paguhet taksa e regjistrimit.
2. Taksa e regjistrimit është e ardhur burimore e FPPK-së.
3. Pagesa për regjistrim është e obliguar të kryhet në momentin e dorëzimit të aplikimit për regjistrim ose për vazhdimin e regjistrimit.
4. Lartësinë e pagesave të regjistrimit e cakton Bordi Ekzekutiv i FPPK-së.

Neni 5. – Paraqitja për regjistrim

1. Klubet paraqesin kërkesën për regjistrim duke plotësuar dokumentacionin e plotë dhe të nevojshëm për stinorin garues.
2. Dokumentacioni i paraqitur duhet të jetë i plotë dhe i verifikuar nga FPPK.
3. Për çdo sportist të regjistruar bëhet evidentimi në listën e anëtarësisë.
4. Lista e anëtarësisë përditësohet rregullisht pas çdo regjistrimi të ri dhe konsiderohet dokument zyrtar i federatës.

Neni 6. Kërkesa për regjistrim

1. Kërkesa për regjistrim ose për ripërtëritjen e regjistrimit dorëzohet nga klubi pranë Komisionit të Regjistrimit dhe Garave të FPPK-së.
2. Kërkesa duhet të përmbajë patjetër:
 - Emrin e klubit;
 - Vendin dhe adresën e selisë së klubit;
 - Emrin, adresën dhe numrin e telefonit të personave përgjegjës (përfaqësuesi i autorizuar, kryetari dhe sekretari);
 - Të dhënat e personit të autorizuar për kontakte me FPPK-në;
 - Numrin e ekipeve sipas ligave dhe gjinive;
 - Ekipin bazë, nëse klubi ka më shumë se një ekip.
 - Letërkonfirmimin e përfaqësuesit të autorizuar, të lëshuar me datë të vitit aktual..

Neni 7 – Dokumentacioni i nevojshëm për regjistrimin e parë

1. Për regjistrimin e parë të klubit është e nevojshme të dorëzohen këto dokumente:
 - 1.1. Aplikacioni për anëtarësim, me obligim të pranimit të statutit të FPPK-së, rregulloreve dhe vendimeve të organeve të saj,
 - 1.2. Lista e plotësuar dhe e nënshkruar me anëtarët e klubit që regjistrohen për vitin përkatës: Përfaqësuesi i autorizuar, kryetari, sekretari, së paku dy anëtar të bordit, trajneri/et, së paku 6 sportistë
 - 1.3. Certifikata ose kopja e noterizuar e regjistrimit si OJQ, ose certifikata e biznesit (shpk/sha).
 - 1.4. Certifikata ose kopja e noterizuar e Numrit Fiskal.
 - 1.5. Vendimi për regjistrimin e klubit në komunën përkatëse.
 - 1.6. Vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve tatimore nga ATK-ja.
 - 1.7. Dëshmia që klubi i përmbush kushtet për veprimtari sportive sipas Ligjit mbi Sportin, duke përfshirë posedimin e infrastrukturës minimale për ushtrimin e veprimtarisë.

- 1.8. Akti i themelimit dhe lista e anëtarëve të kuvendit me së paku pesëmbëdhjetë (15) persona fizik mbi moshën 18 vjeç.
- 1.9. Statuti i klubit/shoqatës me vulë dhe nënshkrim.
- 1.10. Përfaqësuesin e autorizuar të klubit/shoqatës nga Departamenti për OJQ;
 - një person dhe anëtarët e familjes së tij të ngushtë që përfshijnë bashkëshortin, bashkëshortin jashtëmartesorë, prindërit dhe fëmijët, nuk mund të jenë pjesë e organeve qeverisëse e as të jenë aksionarë në vlerë prej më shumë se një (1) % të të gjithë kapitalit në dy ose më shumë klube të pingpongut.
 - Të mos ketë ndalim ligjor për ushtrimin e veprimtarisë sportive;
- 1.11. Dosja e trajnerit/instruktorit, i cili duhet të plotësojë kushtet ligjore:
 - Të ketë mbushur moshën 18 vjeç;
 - Të ketë diplomë universitare për edukim fizik, ose certifikatë të vlefshme për trajner sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, ose licencë të lëshuar nga një institucion i akredituar jashtë Kosovës;
 - Të mos ketë ndalim ligjor për ushtrimin e veprimtarisë sportive;
 - Si sportist, mund të marrë pjesë vetëm në garat ekipore të klubit të tij.
- 1.12. Aplikimi për regjistrimin e së paku 6 sportistëve jo-udhëheqës, duke përfshirë kontratat e sportistëve profesionistë me klubin.
 - Kontrolli shëndetësor i detyrueshëm për të gjithë sportistët, i kryer nga institucione të licencuara të nivelit sekondar ose terciar të mjekësisë sportive (pranohet edhe kontrolli i kryer jashtë Kosovës).
 - Kopjet e letërnjoftimeve ose certifikatave të lindjes së sportistëve.
 - Fletëlëshimi nga klubi i mëparshëm për sportistët nën moshën 21 vjeç.
- 1.13. Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen edhe në formë elektronike, kur FPPK të ofrojë platformë digjitale.
- 1.14. Aplikimi bëhet duke dërguar dosjen e plotë në formë të skanuar ose origjinalin në formë fizike.

Neni 8 – Dokumentacioni i nevojshëm për ri-regjistrimin

1. Çdo vit, klubi është i obliguar të bëjë ri-regjistrimin pranë FPPK-së. Për ri-regjistrimin, klubi duhet të plotësoj:
 - 1.1. Aplikacionin e klubit për vazhdimin e anëtarësisë.
 - 1.2. Listën e plotësuar dhe të nënshkruar me anëtarët e klubit që regjistrohen për vitin përkatës, e cila duhet të përmbajë:
 - Përfaqësuesin e autorizuar;
 - Kryetarin;
 - Sekretarin;
 - Së paku dy anëtarë të bordit;
 - Trajnerin/ët;
 - Së paku gjashtë (6) sportistë.
 - 1.3. Kontrollin shëndetësor të detyrueshëm për të gjithë sportistët;
 - 1.4. Plotësimin e dokumentacionit të përcaktuar në Nenin 7, nëse ka mungesa.
 - 1.5. Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen edhe në formë elektronike, kur FPPK të ofrojë platformë digjitale.
 - 1.6. Aplikimi bëhet duke dorëzuar dosjen e plotë në formë të skanuar ose origjinalin në formë fizike.

Neni 9 – Afatet e regjistrimit

1. Komisioni i Regjistrimit dhe Garave është i obliguar që brenda 30 ditëve nga data e pranimit të kërkesës të bëjë regjistrimin e klubit.
2. Në rast se regjistrimi nuk kryhet brenda këtij afati, Komisioni i Regjistrimit dhe Garave është i obliguar që, brenda 30 ditëve nga data e pranimit të kërkesës, ta informojë klubin me shkrim për arsyet e mospranimit të regjistrimit.

Neni 10. Njoftimi i ndryshimeve gjatë stinorit garues

1. Për çdo ndryshim me rëndësi që lidhet me regjistrimin e klubit, i bërë gjatë rrjedhës së stinorit garues, klubi është i obliguar ta informojë Komisionin e Regjistrimit dhe Garave brenda afatit prej dhjetë (10) ditësh nga data e ndryshimit.
2. Ndërrimi i emrit të klubit konsiderohet ndryshim me rëndësi sipas pikës 1 të këtij neni. Për këtë rast, klubi është i obliguar të paraqesë:
 - Kërkesën për ndërrimin e emrit, duke shënuar emrin e vjetër dhe të riun;
 - Vendimin e organit kompetent të klubit për ndërrimin e emrit;
 - Fotokopjen e vërtetuar mbi regjistrimin me emër të ri në regjistrin e DOJQ-së.
 - Leterkonfirmimin e përfaqësuesit të autorizuar
3. Klubi ka të drejtë ta përfshijë emrin e sponsorit si pjesë të emrit të tij, një herë gjatë një stinori garues.

Neni 11 – Bashkimi i klubeve

1. Kur bëhet bashkimi i dy ose më shumë klubeve, klubi i porsaformuar regjistrohet në pajtim me dispozitat e Nenit 7 të kësaj Rregulloreje.
2. Klubi i krijuar nga bashkimi nuk mund të regjistrohet derisa klubet që bashkohen të kenë përmbushur të gjitha obligimet e tyre ndaj FPPK-së.

Neni 12 – Pasojat e mosregjistrimit

1. Klubi që nuk e kryen regjistrimin për vitin rrjedhës nuk mund të paraqitet në asnjë nivel të garave që janë në kompetencë të FPPK-së.
2. Nëse klubi nuk dorëzon kërkesën për vazhdimin (ripërtëritjen) e regjistrimit për dy vite radhazi nga data e regjistrimit të fundit, ai shlyhet nga evidenca e FPPK-së.

Neni 13 – Regjistrimi i sportistëve

1. Si sportist mund të regjistrohen të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të njërit nga klubet e pingpongut të Kosovës.
2. Nuk mund të regjistrohet personi i rritur që nuk i gëzon të gjitha të drejtat qytetare.
3. Me pajtimin e lidhjeve të tyre nacionale, mund të regjistrohen edhe shtetasit e huaj që janë anëtarë të klubeve të pingpongut të Kosovës.
4. Vendimin për afatet e procedurës së regjistrimit për stinorin e ardhshëm e merr Bordi Ekzekutiv i FPPK-së në fillim të çdo viti kalendarik.
5. Me kërkesën për regjistrim të parë, Komisionit të Regjistrimit dhe Garave i dorëzohen dokumentet e plotësuar që parashihen në Nenin 7 të kësaj Rregulloreje.

6. Ripërtëritje e regjistrimit të garuesit konsiderohet regjistrimi i përsëritur për të njëjtin klub, në të cilin sportisti ka qenë i regjistruar gjatë stinorit garues që i ka paraprirë stinorit për të cilin bëhet regjistrimi.

Neni 14 – Kalimi i sportistëve

1. Kalimi i sportistit nga një klub në tjetrin mund të bëhet:
 - në fillim të vitit kalendarik, sipas afateve të përcaktuara nga Bordi Ekzekutiv;
 - gjatë afatit kalimtar nga 1 deri më 20 gusht të vitit përkatës.
2. Sportisti i moshës madhore ka të drejtë të kalojë nga një klub në tjetrin çdo vit, brenda afateve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, duke nënshkruar fletëkalimin sipas dëshirës së tij, pa pasur nevojë për fletëlëshimin e klubit të deritashëm.
3. Të gjitha obligimet dhe marrëdhëniet ndërmjet klubit dhe sportistit rregullohen me kontratë të ndërsjellë civile, në të cilën përcaktohen mënyra e angazhimit dhe kushtet e ndërprerjes së kontratës.
4. Në rast se sportisti nënshkruan fletëkalimin për më shumë se një klub, ai regjistrohet për klubin që ka fletëkalimin me datën më të hershme. Si datë e plotfuqishme merret data e protokollit, nëse fletëkalimi është dorëzuar fizikisht në FPPK. Përjashtim nga kjo rregull mund të bëhet vetëm me marrëveshje të përbashkët ndërmjet klubeve të interesuara dhe sportistit, e vërtetuar te protokolluesi publik.

Neni 15 – Ndryshimi i statusit të anëtarëve të klubit

1. Ndryshimi i statusit të anëtarëve të klubit lejohet në të njëjtat afate të përcaktuara në pikën 1 të nenit 14, me kusht që të plotësohen kriteret e përcaktuara në nenet 7 dhe 8 të kësaj Rregulloreje për të gjitha pozitat që preken nga ndryshimi i statusit.

Neni 16. Regjistrimi i sportistit edhe në shtete tjera

2. Sportistëve kosovarë të regjistruar në klubet e Kosovës u mundësohet regjistrimi dhe pjesëmarrja njëkohësisht edhe në ligat e shteteve tjera, me kusht që ata nuk mund të refuzojnë ftesën e Përfaqësueses për kampe, grumbullime apo gara ndërkombëtare. Në rast refuzimi, Drejtori i Përfaqësueses inicion rastin disiplinor në Komisionin Disiplinor.
1. Për të marrë lejen nga federata për regjistrim paralel në shtetin tjetër, klubi aktual i sportistit dërgon kërkesë në federatë. Për marrjen e lejes nga federata mund të aplikohet pagesë.
2. Pagesa zbatohet vetëm nëse është vendosur dhe publikuar nga Bordi Ekzekutiv në fillim të stinorit garues.
3. Për të marrë lejen nga FPPK-ja për të luajtur në klubet e huaja, sportisti duhet të:
 - nënshkruajë kontratën për obligimet ndaj Përzgjedhjes së Kosovës;
 - paguajë dëmshpërblimin klubit nga i cili largohet, sipas kushteve të Nenit 18 të kësaj Rregulloreje dhe tabelës përkatëse;
 - paguajë taksën në FPPK sipas tabelës së mëposhtme.
4. Sportisti është i obliguar të paguajë taksën e vërtetuar çdo herë kur kalon nga një klub i Kosovës në klub të huaj, si dhe në rastet kur angazhohet njëkohësisht në ligat e FPPK-së dhe në ligat e shteteve tjera.

5. Sportistët e huaj që paraqiten për klubet e Kosovës nuk janë të obliguar t'i paguajnë FPPK-së taksën për kalim në klubin e huaj.

Kategoria e sportistit	Pikë
Sportistët që kanë qenë në përbërje të garave ekipore për Përzgjedhjen e të rriturve, së paku 2 herë në katër vitet e fundit	200
Sportistët që janë paraqitur për Përzgjedhjen e Kosovës në garat individuale, së paku 2 herë në katër vitet e fundit	100
Sportistët që kanë qenë në përbërje të garave ekipore për Përzgjedhjen e kadetëve dhe juniorëve në katër vitet e fundit	100
Të gjithë të tjerët	50

Neni 17 – Regjistrimi i sportistëve të huaj

- Për t'u regjistruar si sportist i huaj në klubet e Kosovës, Komisionit të Regjistrimit dhe Garave duhet t'i dorëzohen, brenda afateve të regjistrimit pranveror dhe vjeshtor (secili me kohëzgjatje prej 15 ditësh), këto dokumente:
 - Aplikacioni i regjistrimit i nënshkruar me dorë nga sportisti për klubin ku dëshiron të regjistrohet;
 - Leja e Federatës së huaj nacionale;
 - Dëshmia e pagesës së taksës së përcaktuar nga Bordi për sportistët e huaj;
 - Kontrolli shëndetësor;
 - Pasaporta.
- Sportisti i huaj, i cili fiton shtetësinë kosovare pas mbarimit të afatit kalimtar, nuk ka të drejtë të paraqitet në garat që janë në kompetencë të FPPK-së gjatë stinorit rrjedhës garues si sportistë kosovar. Deri në fund të atij stinori, ai mund të garojë vetëm si sportist i "huaj".
- Klubi mund të ketë të regjistruar më shumë sportistë të huaj, por në ndeshjet ekipore të organizuara nga FPPK ka të drejtë të paraqitet vetëm një sportist i huaj.

Neni 18 – Kompensimi i klubit për kalimin e sportistëve të rinj

- FPPK-ja vërteton të drejtën e klubit që, me rastin e kalimit të sportistit në klub tjetër, të kërkojë kompensim për mjetet e investuara në zhvillimin e tij gjatë periudhës kur ka qenë anëtar i klubit në kategoritë e grupmoshave të reja.
- Kompensimi mund të kërkohet:
 - nga çdo klub ku sportisti ka qenë i regjistruar dhe pjesë për së paku dy vite të plota, deri në kategorinë U19;
 - vetëm për kalimin e parë të sportistit në kategorinë U21, nga klubi ku ai ka kaluar dy vitet e fundit si junior.
 - E drejta e kompensimit për sportistët deri në kategorinë U19 i takon gjithmonë klubit ku sportisti ka qenë i regjistruar së paku dy vite të plota para kalimit aktual.

3. Për të vërtetuar të drejtën e kompensimit, klubi duhet të dorëzojë së bashku me kërkesën edhe kontratën civile të ndërsjellë me sportistin.
4. Vlerat e kompensimit janë të përcaktuara në tabelën e mëposhtme, e cila është pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje dhe shprehet në pikë.
5. Vlerën e pikës për afatet e regjistrimit dhe afatin kalimtar e cakton Bordi Ekzekutiv i FPPK-së në mbledhjen e tij, njëkohësisht kur vendoset edhe për afatet e regjistrimit/kalimit.
6. Përveç pikëve përkatëse për sportistin sipas ranglistës, klubit ka të drejtë në kompenzim edhe për 100 pikë për çdo vit që sportisti ka qenë i regjistruar në Federatë pa ndërprerje. Kjo e drejtë realizohet vetëm nëse sportisti ka qenë i regjistruar së paku vitin e fundit në klub. Këto pikë shtohen mbi vlerat e përcaktuara në tabelë.
7. Nëse sportisti është i renditur në më shumë kategori, për bazë merret ranglista e moshës momentale të sportistit. Nëse është i renditur njëkohësisht në ranglistën kombëtare dhe evropiane, për bazë merret ranglista më e lartë sipas moshës momentale.

Ranglista	U15	U19	U21
E Kosovës			
1-5	800	1000	1200
6-10	400	500	600
11-20	200	250	300
E Evropës			
1-10	3000	6000	15000
11-20	1500	4000	10000
21-30	1000	3000	6000
30-50		2000	5000
51-100			3500

Neni 19 – Rishqyrtimi i vendimit

1. Kundër çdo vendimi të Komisionit të Regjistrimit dhe Garave mund të bëhet kërkesë për rishqyrtim brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të vendimit. Komisioni shqyrton rastin së bashku me dokumentet shtesë dhe merr vendim brenda afatit prej 7 ditësh nga pranimi i kërkesës.

Neni 20 – Ankesa në shkallën e dytë

1. Ankesa ndaj vendimit të Komisionit të Regjistrimit dhe Garave i parashtrohet Bordit të Apelit si shkallë e dytë, brenda afatit prej 30 ditësh nga dorëzimi zyrtar i vendimit. Bordi i Apelit është i obliguar ta shqyrtojë dhe ta zgjidhë ankesën brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të saj.

Neni 21 – Ankesa pas Afatit

1. Ankesat e bëra pas afatit të përcaktuar në Nenin 20 do të konsiderohen të pasafatshme.

2. Vendimet e Bordit të Apelit për të gjitha ankesat lidhur me procedurën e regjistrimit janë përfundimtare dhe të detyrueshme për palët.

Neni 22 – Komisioni i regjistrimit dhe garave

1. Bordi i FPPK-së e emëron Komisionin e Regjistrimit dhe Garave, i cili përbëhet nga tre (3) anëtarë.
2. Komisioni punon në mbledhje, për të cilat mbahet procesverbal.
3. Mandati i Komisionit zgjat aq sa zgjat mandati i Bordit që e ka emëruar.

Neni 23 – Kompetencat e Komisionit


1. Komisioni i Regjistrimit dhe Garave ka këto kompetenca:
 - Bën regjistrimin e klubeve dhe të anëtarëve të tyre dhe lëshon dokumentacionin përkatës sipas kësaj Rregulloreje;
 - Shqyrton dhe zgjedh ankesat e shkallës së parë;
 - Udhëheq evidencën e klubeve dhe sportistëve;
 - Jep pëlqimin për kalimin e sportistëve në klubet e huaja.

Neni 24 – Dokumentet e regjistrimit

1. Dokumentet e regjistrimit udhëhiqen nga parime publike, të hapura, të sakta dhe të vërteta.
2. Përveç kopjes fizike, mbahet edhe databaza elektronike me të gjitha shënimet e skanuara dhe elektronike të sportistëve dhe klubeve.

Neni 25 – Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi 7 ditë pas nënshkrimit nga Kryetari i FPPK-së, publikohet në faqen zyrtare të Federatës dhe është e detyrueshme për të gjitha klubet dhe anëtarët nga dita e hyrjes në fuqi..


JETON ORUQI

Kryetar i Federatës së Pingpongut të Kosovës

Prishtinë,
09/03/2026